

PSH .nr. 517/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Goran Milenković - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: OE NT “BITI-COM” - Podujevë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë o operatori ekonomik: NTP “LULISHTJA BUÇAJ” - Graçanicë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me Lule dhe Drunjë Dekorativ”, me nr. të prokurimit: 616-20-1766-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ KK Prishtinë, më datën: 17.09.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: NT “BITI-COM” - Podujevë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me Lule dhe Drunjë Dekorativ”, me nr. të prokurimit: 616-20-1766-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ KK Prishtinë.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me Lule dhe Drunjë Dekorativ”, me nr. të prokurimit: 616-20-1766-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ KK Prishtinë dhe lënda kthehet në **rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues NT “BITI-COM” - Podujevë, aprovohet si pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues OE NT "BITI-COM" - Podujevë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 30.07.2020 me nr. 517/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me Lule dhe Drunjë Dekorativ", me nr. të prokurimit: 616-20-1766-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ KK Prishtinë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 6, 7, 27, 52, 59, 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës si dhe neni 39 i RRUOPP-së

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 05.08.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 14.08.2020, lidhur me pretendimin ankimor të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në Pretendimi nr. 1

Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë është: Sigurimi i tenderit në vlerë 4,000.00€, dhe në kohëzgjatje prej 120 ditë.

Duke pasur parasysh kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues NT "BITI-COM", nga Kompania e sigurimeve (SIGURI), për periudhë 90 ditë, dhe në vlerë 4,000.00€, pra sigurimi i tenderit nuk është konform kërkesës, për më tepër mund ti referoni pjesës tabelore të nenit 39 të RRUOPP-së.

Sigurimi i tenderit nuk përmban kushtet e përcaktuara sipas formës standarde pjese e DT	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	57
---	---	----

Përgjigje në Pretendimi nr. 2

Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë është: “OE duhet të dëshmojë se drunjtë dekorativ të kërkuar në dosjen e tenderit janë me prejardhje nga vendet e BE. Kërkesa e tille është e domosdoshme për shkak të origjinës së produktit t furnizuar”.

Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: “Kopja e certifikatës fitosanitare dhe të origjinës të cilat dëshmojnë se mallrat janë nga vendet e BE-së”.

Autoriteti kontraktues e ka eliminuar OE ankues NT “BITI-COM”, me arsyetimin: **Operatori ekonomik nuk i ka sjellë të gjitha Certifikatat fitosanitare për të gjitha Lulet dhe Drunjët dekorativë, ashtu siç janë specifikuar në dosje të tenderit dhe në përshkrim të çmimit duke shkelur pikën 9.1 dhe 9.2 të dosjes së tenderit.**

Operatori ekonomik ankues NT “BITI-COM”, pretendon se sa i përket Licencës dhe arsyes për eliminim në ofertë AK-së e ka pasur Vendimin e Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të dt:23.03.2020, i cili e sqaron validitetin e licencave, dhe konform nenit 39.1 të RRUOPP-së, ka mundur të kërkoj sqarime shtesë AK-së.

Në nenin 39.1, të RRUOPP-së, thuhet: “Për të lehtësuar ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, AK mund të kërkoj nga secili tenderues individualisht për sqarim të tenderit të tij/saj. KRPP ka aprovuar një formular standard B47 për sqarime për të përdorur nga AK “Kërkesë për sqarim të tenderit”. Kërkesa për sqarim dhe përgjigja duhet të bëhet përmes platformës elektronike”.

Gjithashtu në pjesën tabelore të nenit 39 të RRUOPP-së, sqarohet qartë, **shihe më poshtë:**

Mungon licenca	Mund te kërkohen informata sqaruese	66
Mungon certifikata ISO	Mund te kërkohen informata sqaruese	69

Duke pasur parasysh kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, dëshmime të ofruara në dosjen e tenderit, si dhe nenin 39 të RRUOPP-së, eksperti shqyrtues sqaron se AK-së, nuk ka vepruar konform këtij neni.

Përgjigje në Pretendimi nr. 3

Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë është: “OE duhet të ketë licence për eksport, import, tregtim dhe prodhimin e drunjtëve dekorativ”.

Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: “Kopja e licencës për export, import, tregtim, prodhim të drunjtëve dekorativ e lëshuar nga MBPZHR”.

Eksperti shqyrtues sqaron se duke pasur parasysh, kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, dëshmitë e ofruara nga OE ankues NT “BITI-COM”, AK-së, konform nenit 39 të RRUOPP-së, është dashur të sqaroj të gjitha paqartësitë në lidhje me kërkesën e dosjes së tenderit.

Përgjigje në Pretendimi nr. 4

Eksperti shqyrtues konstaton se OE ankues NT “BITI-COM”, pretendon se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës NTP “LULISHTJA BUÇAJ”, menaxherin Leotrim (Naser) Krasniqi, i cili është Bachelor i Agro Ekonomisë, nuk e ka ofruar konform kërkesës së dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë ku është kërkuar AGRONOM I DIPLOMUAR.

Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, është: “OE duhet të emëroj menaxherin e projektit, i cili duhet të jetë Agronom i diplomuar (Drejtimi Agroekonomi). Në rast të grupit Menaxheri duhet të jetë pjesë e stafit të Liderit”. Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: “OE në kuadër të stafit duhet të ketë një deklaratë origjinale ku emërton menaxherin e projektit i cili duhet të jetë Agronom i diplomuar (Drejtimi Agroekonomi) ose marrëveshje paraprake për angazhim në projektin përkatëse, me së paku 3 vite përvojë pune në OE e dëshmuar me CV, diplomën mbi kualifikimin (e noterizuar), kontratën e punës, dëshmi mbi përvojën e punës nga ATK-ja, të jetë në listën e të punësuarve në OE dhe të ofroj së paku 3 referenca për menaxhim të suksesshëm të projekteve të ngjashme në OE”.

Eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës NTP “LULISHTJA BUÇAJ”, në dosjen e tenderit e ka ofruar z. Leotrim (NASER) Krasniqi, me titull “BACHELLOR I AGROEKONOMISË”, shih më poshtë.



REPUBLIKA E KOSOVËS
UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"

FAKULTETI I BUDQËSISË DHE VETERINARISË NË PRISHTINË

REPUBLIC OF KOSOVO
UNIVERSITY OF PRISHTINA
"HASAN PRISHTINA"

FACULTY OF AGRICULTURE AND VETERINARY IN PRISHTINA



LEOTRIM NASER KRASNIQI

U lind më 04.06.1991 në Lipjan.
U regjistrua në vitin akademik 2010/2011.
Studimet i mbaroi më 23 korrik 2015 në:
(DREJTIM) AGRO EKONOMI

and was awarded the title:
BACHELOR I AGRO EKONOMISË

Niveli i kualifikimit sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve: 6
Gjithsej 180 (180) ECTS
Nota mesatare gjatë studimeve: 6.53
Prishtinë, 1 Shtator 2015

Born on 04.06.1991 in Lipjan.
Was enrolled in the academic year 2010/2011.
Completed his/her studies on 23 July 2015 for:
Agro - ECONOMY

and was awarded the title:
BACHELOR OF AGRO - ECONOMY

Level of qualification according to the National Qualifications Framework: 6
Total ECTS 180
Average grade of studies 6.53
Prishtina, 1 September 2015

Nr. 447

Dekani / Dean
Prof. Asoc. Dr. Bedri Dragusha

Rektor / Rector
Prof. Dr. Ramadan Zejnullahu



Kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është **"Agronom i diplomuar (Drejtimi Agroekonomi)"**, ndërsa në Diplomë shënon **"BACHELOR I AGRO EKONOMI"**, duke pasur parasysh kërkesën e dosjes së tenderit dhe dëshminë e ofruar, eksperti shqyrtues sqaron se konform nenit 59.2 të LPP-së, AK-së është dashur të kërkoj sqarime shtesë nga organi kompetent që e ka leshur diplomën, për gradën **"BACHELOR I AGRO EKONOMI"**.

Përgjigje në Pretendimi nr. 5

Eksperti shqyrtues konstaton se OE ankues NT "BITI-COM", pretendon se Certifikatat e origjinës së mallit Itali, ofruara nga OE i rekomanduar për dhënie të kontratës NTP "LULISHTJA BUÇAJ", janë të dyshimta (të falsifikuara), nëntë nga to janë me numër fitosanitarisë Z/0795635, dy tjera janë me numër Z/0230924, dy me numër të njëjtë V/0418330, ndërsa dy me datë të njëjtë 04.03.2020, me nr. UE-IT 0980105 si dhe dy tjera me dt:24.04.2020 EU-IT 1 – 0983509, EU-IT-2 – 0979897.

Po ashtu OE ankues NT "BITI-COM", pretendon se tri (3) Licencat e OE të rekomanduar për dhënie të kontratës i konsideron si të falsifikuara, vetëm njëra nga to është origjinale.

Sa i përket pretendimeve në lidhje me Certifikatat dhe Licencat e OE të rekomanduar për dhënie të kontratës, ku OE ankues NT "BITI-COM", pretendon se janë të falsifikuara, eksperti shqyrtues sqaron se kjo çështje është përgjegjësi i organeve përgjegjëse që merren me këto punë, nuk është përgjegjësi e jonë kjo si dhe nuk kemi mekanizmat e nevojshme, për tu marrë me vërtetësinë e këtyre dokumenteve.

Gjithashtu ky pretendim ankimor nuk është në kërkesën për rishqyrtim tek AK-së.

Në nenin 9.2 Rregullat për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave thuhet: “Ankesa do të dorëzohet në origjinal tek Organi Shqyrtues i Prokurimit “OSHP” dhe njëkohësisht, një kopje e ankesës do t’i dorëzohet Autoritetit Kontraktues. Pretendimet ankimore duhet të jenë të njëjta me ato të paraqitura në Autoritetin Kontraktues”.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 17.08.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se Nuk Pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datë: 17.08.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se Pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 17.09.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Paneli shqyrtues sqaron se lidhur me arsyen e eliminimit të OE ankues, kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë ka qenë: Sigurimi i tenderit në vlerë 4,000.00€, dhe në kohëzgjatje prej 120 ditë. OE ankues NT “BITI-COM”, nga Kompania e sigurimeve (SIGURI), ka dhënë sigurimin për periudhën 90

ditë, dhe në vlerë 4,000.00€. Pra, sigurimi i tenderit nuk është konform kërkesës. Duke u bazuar në nenin 39 të RRUOPP-së, ku thuhet se nëse sigurimi i tenderit nuk përmban kushtet e përcaktuara sipas formes standarte pjesë e dosjes së tenderit- refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm, paneli shqyrtues vlerëson se OE ankues për shkak të mos plotësimit të kësaj kërkesë të dosjes së tenderit, është i papërgjegjeshëm.

Sa i përket kërkesës së dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë: “OE duhet të dëshmojë se drunjtë dekorativ të kërkuar në dosjen e tenderit janë me prejardhje nga vendet e BE. Kërkesa e tillë është e domosdoshme për shkak të origjinës së produktit të furnizuar”. Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: “Kopja e certifikatës fitosanitare dhe të origjinës të cilat dëshmojnë se mallrat janë nga vendet e BE-së”. Paneli shqyrtues sqaron se Autoriteti kontraktues e ka eliminuar OE ankues NT “BITI-COM”, me arsyetimin: Operatori ekonomik nuk i ka sjellë të gjitha Certifikatat fitosanitare për të gjitha Lulet dhe Drunjët dekorativë, ashtu siç janë specifikuar në dosje të tenderit dhe në përshkrim të çmimit duke shkelur pikën 9.1 dhe 9.2 të dosjes së tenderit. Operatori ekonomik ankues NT “BITI-COM”, pretendon se sa i përket Licencës dhe arsyes për eliminim në ofertë AK-së e ka pasur Vendimin e Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të dt:23.03.2020, i cili e sqaron validitetin e licencave, dhe konform nenit 39.1 të RRUOPP-së, ka mundur të kërkojë sqarime shtesë AK-së.

Paneli shqyrtues sqaron se në nenin 39.1, të RRUOPP-së, thuhet: “Për të lehtësuar ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, AK mund të kërkojë nga secili tenderues individualisht për sqarim të tenderit të tij/saj. KRPP ka aprovuar një formular standard B47 për sqarime për të përdorur nga AK “Kërkesë për sqarim të tenderit”. Kërkesa për sqarim dhe përgjigja duhet të bëhet përmes platformës elektronike”. Ak ka mundur të kërkojë sqarime nga OE për këtë pikë.

Poashtu edhe në lidhje me kërkesën e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë ku thuhet: “OE duhet të ketë licence për eksport, import, tregtim dhe prodhimin e drunjtëve dekorativ”. Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: “Kopja e licencës për export, import, tregtim, prodhim të drunjtëve dekorativ e lëshuar nga MBPZHR”. Paneli shqyrtues sqaron se duke pasur parasysh, kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, dëshmitë e ofruara nga OE ankues NT “BITI-COM”, AK, konform nenit 39 të RRUOPP-së, është dashur të sqarojë të gjitha paqartësitë në lidhje me kërkesën e dosjes së tenderit.

Sa i përket pretendimit ankimor të OE ankues NT “BITI-COM”, se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës NTP “LULISHTJA BUÇAJ”, menaxherin Leotrim (Naser) Krasniqi, i cili është Bachelor i Agro Ekonomisë, nuk e ka ofruar konform kërkesës së dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë ku është kërkuar AGRONOM I DIPLOMUAR. Paneli shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe të

njoftimit për kontratë është: “OE duhet të emëroj menaxherin e projektit, i cili duhet të jetë Agronom i diplomuar (Drejtimi Agroekonomi). Në rast të grupit Menaxheri duhet të jetë pjesë e stafit të Liderit”. Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: “OE në kuadër të stafit duhet të ketë një deklaratë origjinale ku emërton menaxherin e projektit i cili duhet të jetë Agronom i diplomuar (Drejtimi Agroekonomi) ose marrëveshje paraprake për angazhim në projektin përkatëse, me së paku 3 vite përvojë pune në OE e dëshmuar me CV, diplomën mbi kualifikimin (e noterizuar), kontratën e punës, dëshmi mbi përvojën e punës nga ATK-ja, të jetë në listën e të punësuarve në OE dhe të ofroj së paku 3 referenca për menaxhim të suksesshëm të projekteve të ngjashme në OE”.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të dokumentacionit të ofruar për këtë pikë nga OE i rekomanduar sqaron se i njëjti në dosjen e tenderit për kërkesën e cekur si më lartë, e ka ofruar z. Leotrim (NASER) Krasniqi, me titull “BACHELLOR I AGROEKONOMISË”.

Kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është “Agronom i diplomuar (Drejtimi Agroekonomi)”, ndërsa në Diplomë shënon “BACHELOR I AGRO EKONOMI”.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në kërkesën e AK-së dhe dokumentacionin e ofruar nga AK sqaron se AK gjatë rivlerësimit të aktivitetit të prokurimit duhet të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59. 2 dhe 72 të LPP-së në mënyrë që të vërtetoj nga organi kompetent që ka lëshuar diplomën dhe të vërtetoj se a janë të barabarta gradat me sistemin e ri të studimëve, më saktësisht a janë të barazvlefshme grada “bachelor i Agroekonomisë” me “Agronom i diplomuar” dhe që AK të specifikoj çartë se a përputhet diploma e ofruar nga OE i rekomanduar me kërkesën e bërë nga ata.

Në lidhje me pretendimin e OE ankues NT “BITI-COM”, pretendon se Certifikatat e origjinës së mallit Itali, të ofruara nga OE i rekomanduar për dhënie të kontratës NTP “LULISHTJA BUÇAJ”, janë të dyshimta (të falsifikuara), nëntë nga to janë me numër fitosanitarisë Z/0795635, dy tjera janë me numër Z/0230924, dy me numër të njëjtë V/0418330, ndërsa dy me datë të njëjtë 04.03.2020, me nr. UE-IT 0980105 si dhe dy tjera me dt:24.04.2020 EU-IT 1 – 0983509, EU-IT-2 – 0979897. Po ashtu OE ankues NT “BITI-COM”, pretendon se tri (3) Licencat e OE të rekomanduar për dhënie të kontratës i konsideron si të falsifikuara, vetëm njëra nga to është origjinale.

Paneli shqyrtues konstaton se sa i përket pretendimeve në lidhje me Certifikatat dhe Licencat e OE të rekomanduar për dhënie të kontratës, ku OE ankues NT “BITI-COM”, pretendon se janë të falsifikuara, kjo çështje është përgjegjësi i organeve përgjegjëse, pasi që ne nuk jemi autoritet që mund të bëjmë verifikimin dhe nuk kemi mekanizmat e nevojshme, për tu marrë me vërtetësinë e këtyre dokumenteve. Për më tepër paneli shqyrtues konstaton se ky pretendim nuk ka qenë në kërkesën për rishqyrtim drejtuar AK-së, andaj si i tilë edhe nuk mund të shqyrtohet pasiqë duke u bazuar në nenin 9. 2 të Rregullave për

paraqitje të ankesave në AK dhe OSHP Formulari F03, të gjitha pretendimet ankimore të bëra në OSHP duhet të jenë të njëjta me ato të bëra në AK.

Rregullat për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave thuhet: “Ankesa do të dorëzohet në origjinal tek Organi Shqyrtues i Prokurimit “OSHP” dhe njëkohësisht, një kopje e ankesës do t’i dorëzohet Autoritetit Kontraktues. Pretendimet ankimore duhet të jenë të njëjta me ato të paraqitura në Autoritetin Kontraktues”.

Paneli shqyrtues pasiqë analizoj të gjitha pretendimet ankimore vlerëson se AK gjatë rivlerësimit duhet të bëjë verifikimin e diplomës të ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë më saktësisht që kërkoj informata shtesë lidhur me këtë pikë nga Organet gjegjëse në mënyrë që të qartësojë se a është plotësuar kërkesa e dosjes së tenderit “Agronom i diplomuar”.

Paneli shqyrtues vlerëson se AK gjatë rivlerësimit do të veproj në harmoni me të gjitha dispozitat e LPP-së me saktësisht do të ketë parasysh qëllimin e këtij ligji gjatë zhvillimit të kësaj procedure të prokurimit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t’i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
z. Goran Milenković



Vendimi t’i dorëzohet:

1x1 AK - “KK Prishtinë”

1x1 OE – NT “BITI-COM”-Podujevë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.